

## Vendim nr. 283 datë 25.11.2024

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Genti Ibrahim, Marjana Semini, Ilir Toska, anëtarë, në datën 25.11.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 1 (Th) 2024 të Regjistrisë Themeltar, që u përket:

<b>KËRKUES:</b>	<b>THODHORI STAMBOLLAJ</b>
<b>OBJEKTI:</b>	Shfuqizimi i vendimeve nr. 41-2020-286 (12/362), datë 24.01.2020 të Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë; nr. 100, datë 25.11.2022 të Gjykatës së Apelit Korçë; nr. 00-2024-189, datë 08.02.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
<b>BAZA LIGJORE:</b>	Nenet 27, 28, 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 134, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ( <i>Kushtetuta</i> ); nenet 27 e vijues dhe 32 e vijues të ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar ( <i>ligji nr. 8577/2000</i> ).

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (*Mbledhja e Gjyqtarëve*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

### V Ë R E N:

#### I

#### Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Thodhori Stambollaj dhe shtetasit, bashkëshortët, P.S. dhe R.S., në datën 24.06.2009 kanë lidhur një kontratë huaje noteriale, sipas së cilës kërkuesi u ka dhënë atyre një

hua në shumën 6 000 000 lekë, me afat kthimi deri në datën 05.01.2010. Për garantimin e detyrimit për kthimin e huasë, në të njëjtën datë, është lidhur edhe një kontratë hipotekimi, sipas së cilës huamarrësit kanë vendosur në hipotekë, në favor të kërkuesit, pasurinë e tyre truall dhe ndërtesë, të ndodhur në fshatin Barç, Korçë.

2. Me pretendimin se huaja nuk i ishte kthyer, megjithëse kishin kaluar më shumë se 9 vjet, dhe se huamarrësit prej disa kohësh u ishin shmangur kontakteve me të, kërkuesi, në datën 13.02.2019, ka paraqitur kallëzim penal ndaj tyre në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë (*Prokuroria e Korçës*) për veprën penale “Mashtrimi”, të parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal (*KP*). Pas kryerjes së disa verifikimeve, me vendimin e datës 04.03.2019, Prokuroria e Korçës, bazuar në nenet 290, pika 1, shkronja “ç” dhe 291 të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*), ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, me arsyetimin se fakti i kallëzuar nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, pasi në rastin konkret jemi përpara një kontrate noteriale huaje dhe kallëzuesi duhet t’i drejtohej gjykatës me padi civile për zgjidhjen e konfliktit.

3. Duke mos qenë dakord me vendimin e prokurorit për mosfillimin e procedimit penal, kërkuesi e ka kundërshtuar atë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, e cila, me vendimin nr. 174, datë 21.06.2019, ka vendosur rrëzimin e kërkesës ankimore, me arsyetimin se disponimi i prokurorisë ishte i drejtë dhe veprimet verifikuese ishin të mjaftueshme. Mbi bazën e ankimit të kërkuesit, Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. 89, datë 25.07.2019, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

4. Në datën 16.10.2019 kërkuesi ka marrë një informacion me shkrim nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë, sipas të cilit pasuria e lënë garanci nga huamarrësit për kthimin e huas i ishte shitur një personi të tretë në vitin 2011. Mbi këtë bazë, në datën 04.11.2019 kërkuesi ka paraqitur sërish kallëzim në prokurori, ndaj të njëjtëve persona dhe për të njëjtën vepër penale. Me vendimin e datës 22.11.2019, Prokuroria e Korçës ka vendosur sërish mosfillimin e procedimit penal, me arsyetimin se kallëzuesi ka paraqitur të njëjtat pretendime dhe prova, për të cilat është dhënë më parë një vendim që është vlerësuar i drejtë nga gjykata.

5. Kërkuesi e ka kundërshtuar sërish vendimin e prokurorit për mosfillimin e procedimit penal dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. 12/362, datë 24.01.2020, ka vendosur rrëzimin e kërkesës ankimore. Mbi ankimin e kërkuesit, Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. 70, datë 18.09.2020, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së

parë. Kurse Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, mbi rekursin e kërkuarit, me vendimin nr. 00-2022-1048 (220), datë 13.09.2022, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe kthimin asaj të akteve për rishqyrtim.

6. Në rigjykim, Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr.100, datë 25.11.2022, ka vendosur sërish lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Për rekursin e kërkuarit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-189, datë 08.02.2024, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e tij.

7. Në datën 12.08.2024, përmes shërbimit postar, kërkuari i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar më 18.09.2024.

## II

### Pretendimet e kërkuarit

8. **Kërkuari**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor* në drejtim të:

- 8.1. *Së drejtës së aksesit dhe të ankimit substancial*, pasi gjykatat më të ulëta dhe prokuroria nuk kanë kryer një hetim të plotë e të gjithanshëm, duke mos analizuar provën e re shkresore lidhur me pasurinë e vënë si garanci hipotekare për garantimin e huas, si dhe nuk kanë arsyetuar në lidhje me pretendimet e tij. Kohëzgjatja e procesit të themelit lidhur me gjykimin e çështjes pas 5 vjetësh nga regjistrimi i kallëzimit, si dhe mosveprimi i Gjykatës së Lartë lidhur me kërkesën për përshpejtimin e procedurave dhe gjykimin brenda një afati të arsyeshëm të rekursit kanë rrezikuar afatet e parashkrimit të veprës penale.
- 8.2. *Së drejtës për t'u dëgjuar në aspekt të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi gjykatat nuk kanë argumentuar mjaftueshëm për pretendimet e paraqitura, ndërsa Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë zgjidhje në thelb pretendimeve të tij.

## III

### Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve

A. *Për legjitimitimin e kërkuarit*

9. Çështja e legjitimitit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhen me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas nenit 131, pika 1, shkronja “F”, nenit 134, pika 1, shkronja “i” dhe nenit 134, pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

10. Lidhur me legjitimitimin *ratione personae*, Gjykata ka pohuar se, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, individi duhet të provojë interesin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial (*shih vendimet nr. 65, datë 30.11.2023; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se kërkuesi ka kundërshtuar procesin gjyqësor penal në përfundim të të cilit është vendosur rrëzimi i kërkesës së tij ankimore ndaj vendimit të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal për veprën penale “Mashtrimi”, të parashikuar nga neni 143 i KP-së, duke lënë kështu praktikisht në fuqi këtë vendim. Për rrjedhojë, në aspektin procedural të këtij kriteri legjitimimi, kërkuesi rezulton të ketë qenë palë në procesin gjyqësor të kundërshtuar. Ndërsa për sa i përket aspektit substancial të këtij kriteri, Gjykata ka theksuar se individi, si subjekt i kushtëzuar, mund të bëjë kërkesë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejta, si dhe të provojë se në çfarë mënyre ai është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga masa/akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të (*shih vendimet nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, kërkuesi duhet të provojë edhe se është bartës i asaj të drejte/lirie kushtetuese që pretendohet se është cenuar nga vendimet gjyqësore objekt kërkesë.

12. Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se procesi gjyqësor objekt i ankimit kushtetues ka të bëjë me kundërshtimin e vendimit të Prokurorisë së Korçës për mosfillimin e procedimit penal në lidhje me kallëzimin e kërkuetit, për veprën penale të parashikuar nga neni 143 i KP-së, ndaj disa personave (huamarrës), marrë shkas nga mosrespektimi prej tyre, për një periudhë të gjatë kohore,

i detyrimeve të lindura nga një kontratë noteriale huaje. Sipas Prokurorisë së Korçës, duke qenë përpara një marrëdhënieje juridike civile të lindur nga kontrata e huas, kërkuesi duhet t'i drejtohej gjykatës me padi civile. Ky disponim është gjetur i drejtë nga gjykatat, të cilat e kanë lënë në fuqi vendimin e prokurorisë.

13. Duke pasur parasysh faktet dhe natyrën e kësaj çështjeje, Mbledhja e Gjyqtarëve do të ndalet në verifikimin e së drejtës kushtetuese që vihet në diskutim dhe, më tej, në drejtim të pasojave që i kanë ardhur kërkuesit në atë të drejtë, në kuptim të justifikimit prej tij të statusit të viktimës. Mbledhja e Gjyqtarëve vëren, së pari, se pretendimet e kërkuesit janë fokusuar në aspektet procedurale të procesit të kundërshtuar, pa arritur të evidentojë të drejtën kushtetuese me natyrë substanciale që kërkon të mbrojtë përmes ushtrimit të së drejtës kushtetuese me natyrë procedurale, asaj për proces të rregullt.

14. Megjithatë, duke pasur parasysh marrëdhënien mes palëve (huadhënësit/kërkuesit dhe huamarrësve/të kallëzuarve), edhe nëse do të konsiderohej se qëllimi i kërkuesit është kthimi i shumës së dhënë hua, që përfshihet në konceptin e pasurisë, pra mbrohet nga e drejta e pronës private, kërkuesi nuk e ka argumentuar cenimin e kësaj të drejte për shkak të vendimmarrjes së kundërshtuar. Kjo sepse në vetvete efekti ligjor i vendimeve të kundërshtuara nga kërkuesi është mosushtrimi i ndjekjes penale për faktin e kallëzuar prej tij në raport me të dhënat e disponuara dhe situatën faktike në momentin në të cilin ai vendim është marrë. Këto vendime nuk kanë sjellë dhe as mund të sillnin ndonjë pasojë në të drejtën e pronës së kërkuesit, të cilën ai ka pasur të gjitha mundësitë dhe mjetet juridike ta mbrojtë përmes një padie civile, duke iu drejtuar gjykatës për zgjidhjen e konfliktit. Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson të theksojë se interesi substancial i kërkuesit lidhet me të drejtën e pronës private, rivendosja në vend e së cilës, në rastin konkret, nuk duket se varet nga mënyra e përfundimit të procesit penal. Kjo do të thotë se edhe në rastin e një vendimi në favor të tij, mjeti i përdorur nga kërkuesi nuk provohet se do të ofronte një perspektivë suksesi në drejtim të mbrojtjes së të drejtës substanciale, për sa kohë që ai nuk është i tillë që mund të rivendosë të drejtën e pretenduar të cenuar.

15. Në këtë aspekt, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se vlerësimi i këtij kriteri është i ndërlidhur edhe me kriterin e shterimit të mjeteve juridike, për sa kohë që kërkuesi jo vetëm që nuk ka provuar se mjetet juridike të përdorura prej tij (kallëzimi penal dhe ankimi ndaj vendimeve të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal) ishin mjetet e vetme në dispozicion për mbrojtjen

e së drejtës së pretenduar të cenuar dhe se ai nuk ka asnjë mjet tjetër në dispozicion, por edhe se mjetet e tjera, siç është edhe e drejta për të vënë në lëvizje procesin gjyqësor civil, nuk do të ishin efektive në aspektin kushtetues, pra se nga pikëpamja e efektivitetit nuk mund të riparojnë të drejtën e cenuar. Për rrjedhojë, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se kërkuesi nuk legjitimohet t'i drejtohet kësaj Gjykate me ankim kushtetues individual<sup>1</sup>.

16. Në përfundim, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se ankimi kushtetues individual i kërkuesit nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, bazuar në nenet 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “b” dhe “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

---

<sup>1</sup> Gjyqtaret Sonila Bejtja dhe Marjana Semini votuan kundër me arsyetimin se ankimi kushtetues individual i kërkuesit plotëson të gjitha kriteret e legjitimitetit dhe se pretendimet e ngritura nga ai nuk janë haptazi të pabazuara, ndaj çështja duhet të kalonte për shqyrtim në seancë plenare.